



NATYRA DHE ATRAKSIONET

Thethi, një nga fshatrat më të veçantë në Alpet shqiptare, shtrihet në pjesën më veriore të komunës së Shalës dhe është i vendosur në një gropë në lartësinë 700-950 m mbi nivelin e detit.

Thethi ka shume qafa (gryka malesh) te larta:

- a) Qafa e Pejës që e lidh Thethin me Plavën e Gucinë.
- b) Qafa e Valbonës që e lidh Thethin me Rragamin, Valbonën në Tropoje.
- c) Qafa e Derzave që e lidh Thethin me Currajt e Sipërm të Nikaj Mërturit.
- d) Shtegu i Dhenve dhe Qafa e T'thores që e lidhin Thethin me Bogën.
- e) Rrethi i Vizhëns që është ndërmjet majës së Radohimës dhe Qafës së Pejës, që lidh Thethin me Kelmenin e Malësisë së Madhe, në një peisazh mahnitës për të apasionuarit e ecjes në male.

Nga këto qafa dhe shtigje malesh, amatorët dhe profesionistët e Alpinizmit mund të kapin gropën e Thethit. Majat e kësaj kurore diferencohen nga fundi i gropës perreth 1000-1500

metra. Ato ndërtohen nga shkëmbinj gëlqerorë dhe dolomite me ngjyrë të bardhë, gri ose trandafili dhe gëlqerorë ngjyrë hiri të errët. Në veri ngrihet pingu i mprehtë me ngjyrë gri të errët dhe krejtësisht i zhveshur i majës së Harapit “2217,2 metër mbi nivelin e detit”, mjaft e preferuar nga Alpinistët për vështirësitë e saj të njohura në shkallë ndërkombëtare. Aty ngjitur nga lindja, mund të shohësh “Gropën e bukur” nga ku mund të shkelësh parajsën e maleve të Shqipërisë, Jezercën “2692 metër”, majën e Alisë “2471 metër” dhe majën e Papllukës “2569 metër”. Nga kjo anë ngjitesh mbi majën e Boshit “2416 metër”, mbi atë të Drenit ku shihen majat e tjera deri edhe maja e Hekurave “2559.4 metër” dhe Ershelli “2125.5 metër”. Të gjitha vijnë njëra pas tjetres, si kështjella të bardha me forma të ndryshme dhe mbi zona të larta Alpine me plot dukuri akullnajore e karstike.

Në këtë mënyrë kapen edhe majat në perëndim të majës së Harapit, si ajo e Rriskullit “2431 metër”, maja e Madhe “2552.5 metër”, Radohima “2570 metër”, ku zbrit në majën e Zorgjit “1663.8 metër”. Pika më panoramike nga ku mund të shohësh Bjeshkët e Nëmuna dhe Alpet në përgjithësi deri edhe Korabin, në krahinën malore qëndrore të vendit është Radohima. Me një fjalë një “det” malesh, ndër më të bukurat dhe më të veçantat në alpet e Europës e rrethojnë Thethin si kurorë mbretërore, duke i lënë nga Jugu një lidhje të natyrshme me luginën e Shalës. Kjo lidhje është ngushtuar nga pingu shkëmborë të majës së drenit “si kuji Trup, kuji i Zharjedhave, kuji i Lopëve, dhe Gumnari, nga i cili mund të shohësh një pamje të jashtëzakonshme të të gjithë luginës së Thethit” si dhe rrëpirat e pyllëzuara të Majës së Zorgjit. Në këtë ngushtim është formuar edhe kanioni madhështor i Grunasit me gjatësi 2 km, “dhe pjerrësi 76 metër në 1 km”.

Shpellat

Thethi ka edhe monumente të tjera natyrore siç janë shpellat. Speleologu mund të shohë disa shpella të vogla dhe me bukuri të jashtëzakonshme në Theth: Shpellën e Qyqes, shpellën e lugut të Shakujve, shpellën e Kuqe”, shpellën e ndërthurësve në fushë të Thethit “mbi Ulaj”, shpellën e Pepes ne Okol dhe birën e Ujit në qafë të Pejës. Bira e Ujit në qafë të Pejës në kohë shirash nxjerr ujë, që furnizohet nga liqene akullnajore nëntoksore: liqenet e Vuthajve dhe të Jezercës. Por ato që kanë tërhequr vëmendjen e shumë specialistëve alpinistë, speleologë, gjeografë dhe gjeologë, janë shpellat vigane të Harapit mbi Okol dhe shpella e Rrathëve mbi Ulaj. Përmasat e mëdha dhe dukuritë interesante të këtyre shpellave si liqene nëntokësore, sifone, galeri stalaktitesh e stalagmitesh etj., kanë qenë shkaku i krijimit të legjendave nga banorët në shekuj.



Klima e Thethit

Klima e Thethit është mjaft favorizuese për turistët. Karakteristikë e saj është dimri i ftohte dhe me dëborë deri në 2 metër, dhe vera e freskët. Ka shumë vende në majat e larta të maleve ku debora nuk shkrin gjatë gjithë vitit. Në Theth thith ajrin e pastër e të pasur me Jon, që zbret nga malet, “bjeshkët” në luginë, si dhe dritëzimin e qiellit të kaltër me cilësi të larta, që ruhet gjatë në brendësi të luginave të thella. Shfrytëzimi i rrezeve të pasura me ultravjolete, sidomos nga ora 9^{oo} janë shumë të shëndetshme për njeriun.

Rreshjet vjetore janë të bollshme “2921 mm”. Ato shpërndahen sipas stinëve në këtë mënyrë: në Pranverë 21%, në Verë 9%, në Vjeshtë 32% dhe në Dimër 38%. Në pjesën e mirë të tyre bien në formë dëbore duke krijuar një shtresë të qëndrueshme për disa muaj. Me pak shpenzime, korridoret e luginës me borë të qëndrueshme mund të plotësojnë përmasat e stadimeve për ushtrimin e sportit të bukur të skive.

Burimet

Vendimtare për të gjitha llojet e turizmit janë ujërat e shumtë që burojnë në Theth. Të rralla janë vendet me ujëra të bollshme si Thethi në të gjitha alpet e Europës. Ujërat takohen në çdo vend që të shkelësh në Theth, nga lartësitet e maleve, në qendër, dhe ruajnë prurje të konsiderueshme në të gjitha stinët e vitit. Ujërat në Theth kanë pastërti të

përhershme dhe temperatura shumë të ulta. Thethi ka një lumë që kalon përmes fshatit, me temperaturë në burime 6°C - 7°C dhe me troftë të shijshme.

Në Theth numërohen mbi 80 burime e përrenj që shuajnë etjen, tretin ushqimin dhe kalitin trupin. Burimet sipas lagjeve janë:

- a) Në Okol: Gurra e Shtrazës që është burimi i lumit të Thethit, dhe ajo e Gjarpërit.
- b) Në Gjellaj: Gurra e Rupës së Thepit, e Hithave, Gurra e Breishtës, e Kajgjonës, e Ligatës, e Qafës së Valbonës, dhe e Shkallës së valbonës.
- c) Në Gjeçaj: Gurra e Micanit (e njohur për vetitë e saj të mira nga analizat e kryera në Austri në vitin 1915), Gurra e Rranxave, e Balçinës, e Praçes e Gjelaçinës, e Lymyshkës, e Qukave, Gurra e ftohtë e Thanës, kroi i Ndre Markut dhe i Praçes.
- d) Në Nikgjonaj: Gurra e Dardhës, e Mollës, e Shkafes dhe e Surrave.
- e) Në Kolaj dhe Ulaj: Gurra e Dudve, e Majashpellave, e Bjeshkës, e Lugut të Ashtit, e Lugut të Birës, në fushë.

DISA ASPEKTE HISTORIKE

Thethi për herë të parë në dokumenta del në vitin 1485, me emrin Fusha dhe kishte 7 shtëpi (Defteri i rregjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, vëllimi I-rë, botim i 1974, fq.150). Në shekullin XVI-të, kjo zonë nuk përfshihej në sistemin e timarëve. Turqit me qëllim që ta izolonin këtë krahinë nga Malësia e Madhe dhe Shkodra e bashkuan administrativisht me Sanxhakun e Dukagjinit, që e kishte qendrën në Pejë. Në fillim të shekullit XIX-të, Can Deda nga Thethi (fis i Ahcajve) mundi që këtë zonë ta bashkojë me Bushatlinjtë e Shkodrës. P. Coronelli është i pari, që përmend Thethin në hartën e vitit 1688. Në vitin 1916-1917, si meshtar gjendet At Gjecovi, i cili shkruan për fshatin. Në vitin 1936 hapet rruga automobilistike. Në vitin 1937 hapet një agjensi turistike. Me 18 Korrik të vitit 1956 krijohet lëvizja e parë alpinistike në vendin tonë. Në vitin 1956 hapet qendra turistike në godinën e një hoteli, kryesisht për pushimet e punëtorëve dhe të alpinistëve.

ATRAKSIONE KULTURORE

Fshati i Thethit mbart atraksione kulturore të larmishme duke filluar nga veshjet tradicionale, kishat, shtëpите karakteristike, menyra jetesës, etj.

Vendbanimi prehistorik i Grunasit

Grunasi është lagjia më e vjetër e Thethit, ku sapo është zbuluar një vendbanim parahistorik që daton në periudhën e hekurit (më saktë në shek. VIII para Kr.). Ai shtrihet në skajin më ekstrem të kësaj lagjeje, në një hapsirë prej disa hektarësh, të quajtur Gerlë.

Kulla e Ngujimit

Ndodhet po në të njëjtën lagje të fshatit. Është ndërtesë trekatesh prej guri me frengji të ngushta e karakolle. Ngjason me të parën në shumë drejtime, por duke patur një tjetër funksion, atë të shërbimit për persona të ngjuar nga gjakmarrja, është shumë më e ngushtë dhe e lartë. Vetë funksioni i saj, që lidhet me rregullat e Kanunit të Dukagjinit dhe afërsia imediate me rrugen automobilistike, e bën atë tepër të frekuentueshme për vizitorët, që janë të shumtë gjatë gjithë sezionit turistik.

Kisha e Thethit

Kisha e Thethit është kishë e vjetër e franceskanëve që i kushtohet Shnandout. Në të kanë shërbyer figura të shquara të kulturës shqiptare. Ka një arkitekturë tepër interesante të tipit njëanijatëshe, me absidën gjysëmrrethore drejtuar nga lindja, përbri së cilës lartohet një kumbanore elegante.

Mullinjë e ujit

Në fshatin e Thethit ka disa mullinj me ujë, dy prej të cilëve ende në gjendje pune (Nikgjonaj e Kolaj), por që kanë nevojë të restaurohen e të mirëmbahen, kurse ai në Grunas, poshtë kataraktit, pothuajse është dëmtuar rëndë por mund të restaurohet. Ata kanë një vlerë të veçantë etnografike dhe janë një pasuri e vërtetë kulturore

Veshjet tradicionale janë xhubleta për gratë dhe për burrat tirq dhe xhamadan. Gratë mbulojnë kokën me shamitë e tyre tradicionale, për nuset shamitë me trëndafila dhe ngjyra të çelta dhe për ato që mbajnë zi me shami të zeza të cilat i lidhin poshtë fytit. Burrat mbajnë në kokë kësulata e bardha prej leshi.

RRUGA PËR NË THETH

Pikënisja drejt Thethit është qyteti i Shkodrës. Që aty për të vajtur në Theth mund të ndiqni dy rrugë të ndryshme:

1) Rruga më e shkurtër nëpërmjet Koplikut, Bogës dhe Qafës Buni i Thorës (1,786 m) është rreth 68,8 km, por e pakalueshme në dimër. Deri në Bogë rruga është e shtruar, por jo pjesa tjetër.

2) Një rrugë e dytë e cila mund të kalohet gjatë gjithë vitit ndodhet më në jug dhe kalon në Prekaj, Kir, Nikaj-Shalë dhe Nderlyse, kjo rrugë ka një gjatësi prej gjithsej 128,3 km.

Për të dyja rrugët rekomandohet udhëtimi me makinë fuoristradë.

PARKU KOMBËTAR I THETHIT

Gjeomorfologjia e Parkut

Parku i Thethit përbëhet nga tri luginat më të bukura të të gjithë Alpeve shqiptare. Duke filluar me luginën e famshme të Valbonës, që vazhdon deri në Rragam të Shalës me një bukuri të rrallë të shtratit të lumit Valbonë të gjatë 14 km, në kuotën mesatare 600-700m, pastaj duke vazhduar me perden ndërmallore të luginës malore të fshatit Curraj i Epërm (që është në Tropojë) në kuotën 800-1300 m, e gjatësi 12 km. Lugina e tretë që bëhet fjalë është lugina e Thethit që nuk lë prapa edhe dy luginat e tjera ndër malore njëkohësisht dhe si vazhdim në horizont i luginës së Vermoshit. Në anën gjeomorfologjike “Parku Kombëtar i Thethit” me sipërfaqe 2630 ha, ka rëndësi të veçantë. Ai ndodhet rreth 45-50 km nga qyteti i Koplikut dhe 72 km nga Qyteti i Shkodrës. Shtrueshmëria kryesore e tij është në grykërrjedhën e lumit të Thethit. Në veri është maja e Jerzercës 2679 m e lartë. Nga lindja është qafa e Valbonës 1876 m, në jug maja e Zorgjit 1663 m, në perëndim maja e thatë 2543 m. Lugina e Thethit, si vazhdim i luginës së Lumit Shalë, ka këto karakteristika gjeomorfologjike.

Morfologjia

Parku Kombëtar i Thethit përbëhet nga lugina kryesore me bukuri të rrallë të lumit Shalë, që buron rreth 3 km në veri të Thethit dhe në jug shkon deri te maja e Zorgjit, me gjatësi lineare 8 km. Faqet e pllakatës në dy anët e luginës kanë gjatësi 3 km në lindje dhe 4 km në perëndim. Lugina përshkohet nga disa tarraca lumore dhe shpatore. Aksi i vetullës se lindjes është shumë i thikët dhe përkon me reliev të lartë ku vazhdojnë njëra pas tjetrës, Qafa e Valbonës deri tek maja e Radohimës 2570 metër mbi nivelin e detit, rreth 4 km me kuota nga 1968 m në 2217m. Ai shërben si vijë ndarje dhe si pikëvështrimi mbi luginën e Valbonës, luginën e Nikçit (livadhet e Bogës) përroit të thatë, dhe luginës së shalës. Faqja perëndimore është pak më e qetë, në jug-perëndim vazhdon me kuotat 1663.5 maja e Zorgjit dhe në veriperëndim Buni i Tërthores 1775.5 m. Kemi reliev me thikë të aksidentuar që ka kuota 2104 m të Shtegu i dhenve, 2313 m gropa e Radohimës. Kuota mesatare e luginës është 700-900 m, e cila banohet dhe ka bukuri të rrallë që shtohet nga majat dhe kreshtat që e kurorëzojnë. Faqet janë me pjerrësi të madhe dhe të thyera me kënd 16° - 35° por ka raste edhe të pakalueshme 45° - 60° e deri në 90° (në majën e Harapit 2221 m). Kuota më e ulët e parkut është në jug të Thethit 668 m dhe më e larta maja e Radohimes 2570 m mbi nivelin e detit.

Morfometria e luginës së Thethit.

Lugina ka formë pjesërisht korite dhe në veri formen e V-së. Faqet janë pak asimetrike nga vetë formimi dhe kushtet gjeologjike të formimit. Në faqe kemi reliev të ulët dhe tarraca me trashësi deluvionesh që variojnë nga dy deri në katër m, që përbëjnë edhe koren sipërfaqësore për ndërtim pikash turistike. Vërehen gropa të vogla ndërmallore, shpella gëlqerore me gjatësi të konsiderueshme. Nuk kemi ndonjë lëvizje horizontale të kores së sipërfaqes që paraqet rrezikshmëri, kjo e lidhur me trashësinë e deluvioneve. Vërehen aty-këtu shkarje të dheut. Vetë lugina është e vendosur në krahun e një

moloklinali me rënie të butë të formacioneve shkëmbore dhe rënie 15°-35°-40°. Rënia e lehtë e shtresave nuk favorizon rënie por rrëshqitje në këtë luginë.

Rrjeti ujqor i Parkut Kombëtar Theth.

Zona përshkohet nga një rrjet ujqor që rrjedh nga dy shpatet lindore dhe perëndimore në luginë. Lumi kryesor që përshkon parkun është ai i Shalës, i cili funizohet nga përrenj në të dy anët e lumit.

Drejtimi i rrjedhës është nga Veriu për në Jug. Lumi buron në afërsi të qafës së pejqës, në Okol të Thethit. Prurja e lumit shkon deri në 15m³/sek, kur ka rreshje në pjesën e sipërme të luginës.

Përrenjtë kryesorë të luginës dhe lumit të Thethit janë ai i Shan Dedës, i dhenve, i ded'lulës, i Gurrës, i Shkafit, i Valit, i Kufirit dhe përroi i Belonës. Këto përrenj rrjedhin në territor malor e janë të rrëmbyeshëm gjatë dimrit. Në Theth ka edhe shumë burime të cilat mund të shërbejnë si ujësjellësa të pikave turistike me prurje 0.2-10.1/ sek.

Klima

Parku Kombëtar i Thethit ka klimë të ashpër në dimër me reshje që shkojnë nga 1.5 metër në dimër në vende me reliev të ulët dhe maksimumin e arrijne në Qafën e Majave me 3-4 metër. Në dimër e vjeshtë ka rreshje më të shumta. Tipike kemi rreshjet e shiut në qershor që ndikojnë për bujqësinë. Temperaturat luhaten nga -14°C deri në 20°C. Aksi kryesor i luginës nuk mbulohet shumë me dëborë në dimër. Dëbora qëndron më shumë në shpate, kryesisht në pjesën që dielli bie më pak gjatë ditës, në perëndim.

AKTIVITETET QË MUND TË ZHVILLOHEN

Peshkim/Notim

Gjenden disa vende të mundshme për të gjuajtur troftë në lumin e Shalës. Në Theth një nga vendet më të përshtatshme është nën Urën e Gerlës, një vend mahnitës për notim. Gjithashtu në Ndërlysay ka vende për të kapur një peshk të madh. Mund të shkohet për not në lumin e Shalës ose në ujvarat e ndryshme. Ndërsa ka një vend të bukur pranë ujëvarës që ndodhet aty.

Kanotazh

Në lumin e Thethit mund të bëhet kanotazh shumë mirë në periudhat e vjeshtës dhe pranverës kur lumi është me ujë të bollshëm nga shkrirja e dëborës si dhe nga shirat e vjeshtës dhe pranverës. Në realizimin e këtij sporti ndihmon shumë edhe rrjedhja që ka vetë lumi.

Shëtitje/Marshime

Nga Thethi ju mund të shëtitni me ndihmën e një udhërrëfyesi nëpër rrugëkalime të mrekullueshme për një ose disa ditë.

Turne në fshatin e Thethit

Një turne i mrekullueshëm prej tre ose pesë orësh mund të bëhet nëpër vendet më të bukura ose më interesante të fshatit. Ky turne do t'ju çojë në kishën dhe varrezat e fshatit, do t'ju njohë me minihidrocentralin dhe, natyrisht, me dy kullat monumentale. Prej këtu mund të vazhdoni deri në ujëvaren e madhe të fshatit dhe tek ura e Gerlës, 30 metra mbi lumin e Shalës.

Çiklizëm-malor

Turneu i çiklizmit malor në rrugën malore nga Kopluku për në Theth përmes Bunit të Thores (1733 m) dhe prej Thethit përgjatë lumenjve të Shalës dhe të Kirit, kthimi në drejtim të Shkodrës, do të jetë një nga turnetë me të mira të çiklizmit malor në Europë. Rreth 100km rrugë malore të paasfaltuara nëpër një nga peizazhet më të bukura të Shqipërisë.

Speleologji/Ngjitje shkëmbore

Në zonë ka disa shpella, të eksploruara dhe të paeksploruara. Udhërrëfyesit ju cojnë juve në shpellën në Majën e Arapit. Tunelet brenda në shpellë do t'ju cojnë në tre liqene të brendshme, nevojitet që të vini të pajisur mirë.

Ka një faqe vertikale prej rreth 900m. Për ngjitësit e shkembijve kjo duhet të jetë shumë sfiduese. Asnjë udhërrëfyes dhe asnjë pajisje nuk mund të gjendet për ngjitësit e shkembijve në zonë. Shpella e Arapit 13km e gjatë me tre sifone. Shpella e Rrathëve me gjatësi 120 m me formë tektonike dhe puse me ujë. Shpella e ndërgurëve në fushë të Thethit.

Hedhje me parashute

Në malet e Thethit mund të bëhen organizime të hedhjeve me parashutë pasi relievi i thyer e favorizon mjaft mirë këtë lloj sporti.

SHTËPI PRITËSE NË THETH

PALË RUPA

Tel : +355 224 51 45

Tel:+355 68 20 03 93

Email: rorupaog@yahoo.com

Shërbimet që ofron:

Akomodim

Dhoma 4, shtretër 8

Lloji i ushqimit

Qumësht, Bulmet i llojeve të ndryshme, mjalt, vezë fshati, mish i pjekur në hell dhe saç,

lloje të ndryshme supe, mazë, flin, pite me rrathë ose e sheshtë, pula fshati, etj.
Çmimi: 10 Euro për person përfshirë mëngjesin. Dreka/ Darka 15 Euro

Ofron shoqërim në mal dhe shëtitje në bjeshkë.

PREKË HARUSHA

Vendndodhja: Lagja Theth

Tel: +355 69 27 70 294

Shërbimet që ofron:

Akomodim

Dhoma 3, shtretër 12

Lloji i ushqimit

Qumësht, bulmet i llojeve të ndryshme, mjalt, vezë fshati, mish i pjekur në hell dhe saç, peshk troftë, lloje të ndryshme supe, etj.

Çmimi: 25 Euro/person përfshirë të gjitha vaktet.

GJON FRANISHTA

Vendndodhja: Lagja “Nikgjonaj”, Theth

Tel. ++355(0)69 31187128

Ushqimi që shërbehet është tradicional i zonës, ku spikatin prodhimet e bulmetit, qumështi, gjalpi, djathi, kosi, veza, mjalti, mish gici, mish qengji, patate, Të gjitha ushqime bio.

Çmimi është 15 - 20 euro i cili përfshin fjetjen, mëngjesin, drekën dhe darkën.

Në këtë vend ju mund të zbavitni duke luajtur futboll ose volejball. Një fushë bilardo është për ju. Ju ofron shoqërim në mal dhe shëtitje në bjeshkë.

MHILL ÇARKU

Vendndodhja: Lagja “Stakaj”, Theth

Tel : +355 69 31 64 211

Shërbimet që ofron:

Akomodim

Dhoma 5, shtretër 9

Lloji i ushqimit

Tradicional i zones: mish, djathë, kos, gjalp i freskët, fruta dhe zarzavate të stinës.

Çmimi 22 Euro/person përfshirë fjetjen dhe të gjitha vaktet.

PREKË THERTORJA

Tel : +355 68 36 44 788

Shërbimet që ofron:
Akomodim
Dhoma 5, shtretër 13
Lloji i ushqimit
Tradicional i zonës
Çmimi: 10 – 15 Euro për person përfshirë mëngjesin
Dreka/ Darka 10 - 15 Euro

FRAN MOLLA

Vendndodhja: Lagja: “Stakaj” - Theth
Tel.: ++35568 21 80228

Shërbimet që ofron:
Akomodim
Dhoma 5, shtretër 20
Lloji i ushqimit
Qumësht, bulmet i llojeve të ndryshme, mjalt, vezë fshati, mish i pjekur në hell dhe saç,
peshk troftë, lloje të ndryshme supe, mazë, flin, pite me rrathe ose e sheshtë, etj.
Çmimi: 10 – 15 Euro/person përfshirë mëngjesin
Dreka/ Darka 5 – 20 euro

GJON DED NOJA

Vendndodhja: Lagja: “Okol”, Theth
Tel : 00355(0) 68 21 91 405

Shërbimet që ofron:
Akomodim
Dhoma 6, shtretër 10
Lloji i ushqimit
Ushqimi që shërbehet është ai tradicional i zones.
Ofron shoqërim në mal dhe shëtitje në bjeshkë.
Çmimi është 20 euro i cili përfshin fjetjen, mëngjesin, drekën dhe darkën.

GJOVALIN LOKTHI

Vendndodhja: Lagja: “Ulaj” - Theth
Cel: 00 355 68 23 93 992

Shërbimet që ofron:
Akomodim
Dhoma3, shtretër 10
Lloji i ushqimit
Ushqimi që shërbehet është ai tradicional i zones.

Ofron shoqërim në mal dhe shëtitje në bjeshkë.
Çmimi është 15 - 20 euro i cili përfshin fjetjen, mëngjesin, drekën dhe darkën.

NIKOLL POLIA

Vendndodhja: Lagja: “Ndreaj” - Theth
Cel: 00 355 69 30 16 781

Shërbimet që ofron:

Akomodim

Dhoma3, shtretër 10

Lloji i ushqimit

Ushqimi që shërbehet është ai tradicional i zones.

Çmimi është 15 - 20 euro i cili përfshin fjetjen, mëngjesin, drekën dhe darkën.

LULASH KOMETA

Vendndodhja: Lagja: “Okol” - Theth
Cel: 00 355 69 31 64 310

Shërbimet që ofron:

Akomodim

Dhoma 4, shtretër 6

Lloji i ushqimit

Ushqimi që shërbehet është ai tradicional i zonës, ku spikatin prodhimet e bulmetit, qumështi, gjalpi, djathi, kosi, veza, mjalti, mish gici, mish qengji, patate, etj. Të gjitha ushqime bio.

Oborri i shtëpisë së pushimit është i madh dhe i gjelbëruar i mbushur me pemë frutore si mollë, dardha, pjeshkë, kajsi dhe kumbulla.

Në këtë vend ju mund të zbavitni duke u ngjitur në mal apo dhe të shëtitni në bjeshkë.

Çmimi është 15 - 20 euro i cili përfshin fjetjen, mëngjesin, drekën dhe darkën.